



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 408/4 Prot.

Tiranë, më 03.08.2018

VENDIM

Nr.76, datë 03.08.2018

“Mbi verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë në procedurën e lirimit nga shërbimi civil ndaj nëpunësës ***”**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit të përgatitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të verifikimit paraprak të informacionit të marrë nga kërkesa e nëpunësës *****,

VËREJ SE

Nëpërmjet dy kërkesave të regjistruara pranë Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, me nr. 408 prot., datë 16.04.2018 dhe nr. 408/1 prot., datë 20.04.2018, kërkuesja ***** ka ngritur pretendimin për moszbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, si dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, gjatë procedurës së lirimit të saj nga shërbimi civil, si pasojë e mos konfirmimit si nëpunës civil në përfundim të periudhës së provës, për shkak të vlerësimit të rezultateve në punë me nivelin 4 “Jo kënaqshëm”.

Nga verifikimi administrativ i kryer nga Komisioneri, rezulton se, punonjësja ***** është emëruar “Nëpunës civil në periudhë prove”, në pozicionin “Specialist në Sektorin e Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit”, në Drejtorinë Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit, në Inspektoratin Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe

Ujërave në nivel qendror (ISHMPU), me aktin nr. 7742 prot., datë 07.12.2016, të Departamentit të Administratës Publike. Rezulton se, marrëdhënia financiare për këtë nëpunëse ka filluar në datën 17.01.2017 (pra një muaj më pas), sipas urdhrit nr. 19, datë 16.01.2017, të Kryeinspektorit të ISHMPU.

Gjatë periudhës së provës, në zbatim të kërkesave të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se kjo nëpunëse ka kryer me sukses trajnimin e detyrueshëm për nëpunësit civilë në periudhë prove pranë ASPA, në përfundim të të cilit është vlerësuar me 22 pikë, fakt që materializohet me Certifikatën e lëshuar nga ASPA në datën 06.10.2017.

Në kuadër të verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave dhe dobësive të nëpunësit për kryerjen e detyrave, rezulton se për nëpunësen ***** është kryer vlerësimi i rezultateve në punë për periudhën e provës, për të cilën ka marrë dijeni në datën 10.04.2018.

Nga këqyrja e formularit standard të vlerësimit, konstatohet se ai është nënshkruar nga të gjithë personat përgjegjës, të ngarkuar nga ligji për kryerjen e procedurës së vlerësimit (zyrtari raportues, zyrtari kundërfirmues dhe zyrtari autorizues) dhe se për këtë punonjëse është dhënë vlerësimi i nivelit 4, “Jo kënaqshëm”.

Duke mos qenë dakord me këtë vlerësim, në zbatim të Kreut V, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”, i ndryshuar, punonjësja ***** ka ushtruar të drejtën e ankimit, veprim i cili gjen pasqyrim në formularin standard të rezultateve në punë, në ndarjen D), “Nënshkrimi”. Në lidhje me këtë veprim, rezulton se drejtuesi i institucionit (zyrtari autorizues), në ndarjen DH), të formularit standard, në rubrikën “Vlerësimi nga zyrtari autorizues”, ka shënuar me shkrim dore: “Të zbatohen procedurat ligjore sipas vlerësimit të eprorit direkt”.

Në zbatim të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, rezulton se punonjësi ***** me detyrë “Përgjegjës Sektori”, në Sektorin e Inspektimit të Industrisë dhe Veprimtarive Prodhuese në Drejtorinë e Mjedisit, në ISHMPU, i cili ka qenë nëpunësi më i vjetër i vendosur për kujdestarinë e punonjësës në fjalë, nëpërmjet shkresës nr. 1570 prot., datë 13.04.2018, “Dhënie mendimi për nëpunësin në përfundim të periudhës së provës”, ka rekomanduar mos konfirmimin e nëpunësës ***** si pjesë e shërbimit civil.

Rezulton se, në përfundim të periudhës së provës, eprori direkt me vendimin nr. 1599 prot., datë 16.04.2018, ka vendosur mos konfirmimin e punonjësës ***** në përfundim të periudhës së provës. Në vijim të këtij veprimi administrativ, me aktin

administrativ nr. 140, datë 18.04.2018, të Kryeinspektorit të ISHMPU, është urdhëruar lirimi i nëpunëses në fjalë nga shërbimi civil, për arsye të mos konfirmimit të saj si nëpunëse civile, në përfundim të periudhës së provës.

Në vlerësim të rrethanave si dhe dokumentacionit të administruar në kuadër të hetimit administrativ, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil vlerëson se, veprimet administrative të kryera gjatë procedurës së konfirmimit të nëpunësit civil në përfundim të periudhës së provës vijnë në kundërshtim me kërkesat e nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij.

Në përmbajtje të dispozitave që rregullojnë pranimin në shërbimin civil, përcaktohet se, nëpunësi civil, i cili emërohet për herë të parë në shërbimin civil, në pozicione të nivelit ekzekutiv, i nënshtrohet periudhës së provës.

Afati i periudhës së provës si dhe detyrat që duhet të përmbushë nëpunësi dhe institucioni gjatë 1 (një) viti dhe në përfundim të këtij statusi specifik, janë të përcaktuara në nenin 24, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, si dhe në Kreun VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi civil në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit e vendos eprori direkt.

Nga ana tjetër, finalizimi i kësaj procedure bazohet në vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës, proces i cili realizohet nga zyrtari raportues, zyrtari autorizues dhe zyrtari kundërfirmues, sipas përcaktimeve të Kreut I, pika 2, të vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civilë”*, i ndryshuar dhe materializohet me nxjerrjen e vendimit të eprorit direkt për konfirmimin/ ose mos konfirmimin e nëpunësit civil.

Më qëllim përmbushjen e detyrave në kuadër të periudhës së provës, nëpunësi civil në periudhë prove vendoset nën udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil. Në zbatim të Kreut VI, pika 3, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, nëpunësi më i vjetër civil përzgjidhet nëpunës i cili ka vjetërsinë më të madhe në detyrë dhe që bën pjesë në të njëjtën njësi organizative ku është emëruar nëpunësi në periudhë prove.

Në rastin konkret, rezulton se, punonjësi i cili ka kryer rolin e nëpunësit që duhet të kishte nën kujdes punonjësen *****, kryen detyrën e Përgjegjës të Sektorit të Inspektimit të Industrisë dhe Veprimtarive Prodhuese në Drejtorinë e Mjedisit, pranë

ISHMPU-së, e cila nuk ka lidhje me njësinë organizative “*Drejtoria Juridike, Prokurimit, Burimeve Njerëzore dhe Komunikimit*”, ku kjo punonjëse është emëruar si nëpunëse civile në periudhë prove. Përveç kësaj parregullsie, në praktikën që materializon procesin e konfirmimit të nëpunësit civil në përfundim të periudhës së provës, nuk evidentohet asnjë akt administrativ, që të provojë faktin se punonjësi që ka dhënë mendimin për ecurinë e punonjëses, është përzgjedhur në cilësinë e nëpunësit më të vjetër civil.

Në lidhje me këtë fakt, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, arrin në konkluzionin se, dhënia e mendimit me shkrim nga punonjësi i cili ka vepruar me atributin e nëpunësit më të vjetër civil, vjen në kundërshtim me dispozitat e mësipërme, që rregullojnë këtë aspekt të veçantë të administrimit të shërbimit civil.

Për më tepër, duke trajtuar dhe vlerësuar ligjshmërinë e veprimeve administrative të institucionit të ISHMPU, në kuadër të konfirmimit të nëpunësit civil në përfundim të periudhës së provës, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil konstaton elementë të paligjshmërisë gjatë kryerjes së vlerësimit të rezultateve në punë.

Sipas pikës 12, Kreu II, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*”, i ndryshuar, procesi i vlerësimit të rezultateve në punë, ashtu si edhe vlerësimi i punës në fund të periudhës së provës, duhet të kalojë në fazat e mëposhtme:

- a. Planifikimi, ku zyrtari raportues (*i cili, si rregull, është edhe eprori direkt*) takohet me nëpunësin civil që do të vlerësohet për të caktuar objektivat kryesore të punës dhe sjelljet përkatëse profesionale që bëjnë të mundur realizimin e planit të punës, përmbushjen e objektivave dhe të misionit të institucionit. Në këtë fazë zyrtari raportues së bashku me nëpunësin në provë, që do të vlerësohet diskutojnë qëllimet e nëpunësit për karrierë, aspiratat dhe çdo gjë tjetër që lidhet me trajnimin dhe zhvillimin profesional.
- b. Bisedimet e ndërmjetme. Kjo fazë konsiston në takime të strukturuar dhe të shkurtra, të cilat zhvillohen në mes të periudhës së vlerësimit, ku zyrtari raportues takohet më nëpunësin civil dhe vlerëson progresin e bërë në arritjen e objektivave të planifikuara dhe përmirësimet e nevojshme, në planin e hartuar me shkrim.
- c. Vlerësimi përfundimtar, i cili realizohet në përfundim të vitit të provës, konsiston në vlerësimin e përmbledhur të nivelit të suksesit të nëpunësit që do të vlerësohet në arritjen e objektivave kryesore të punës, të përcaktuara në fazën e planifikimit dhe të rishikuar gjatë bisedimeve të ndërmjetme.

Në rastin konkret, nga analiza e dokumentacionit të mbledhur nga subjektet e këtij hetimi administrativ, rezulton se, një procedurë e tillë nuk është respektuar në vlerësimin e rezultateve në punë për punonjësen *****. Në rastin konkret, nuk rezulton të ketë një dokumentacion që materializon zhvillimin e fazës së planifikimit, në të cilën duhet të identifikohen objektivat kryesore të punës dhe sjelljet profesionale që duhet të përmbush nëpunësi apo zhvillimin e fazës së bisedimeve të ndërmjetme për të vlerësuar progresin e nëpunësit që i nënshtrohet vlerësimit. Mosrespektimi i kësaj procedure reflektohet në mungesën e komenteve në të gjitha rubrikat që përmban formulari i vlerësimit të rezultateve në punë, detyrimi cili duhet të përmbushet nga zyrtari raportues dhe zyrtari autorizues.

Procedura e vlerësimit të nëpunësit civil, sipas formatit të miratuar nga Departamenti i Administratës Publike, nuk duhet të konsistojë vetëm në vlerësimin me pikë, por duhet të shoqërohet edhe me komentet përkatëse se nga është nisur zyrtari raportues për të arritur në një përfundim të caktuar, si dhe të përcaktohen në mënyrë konkrete, rekomandimet dhe vërejtjet e nevojshme, të parashikuara në formularin e vlerësimit, me qëllim rritjen e rezultateve dhe arritjen e objektivave më të larta.

Respektimi i këtij detyrimi ligjor, ndikon në një vlerësim objektiv dhe të efektshëm të performancës dhe arritjeve të nëpunësit civil gjatë kryerjes së detyrave të tij dhe për më tepër, ndihmon nëpunësin që në të ardhmen të përqendrohet në ato drejtime të treguara, me qëllim përmbushjen sa më mirë të detyrave dhe nxitjen e rritjes së rezultateve në punë. Mosrespektimi i procedurës së përcaktuar në aktin nënligjor dhe mungesa e dokumentacionit provues të zhvillimit të kësaj procedure, pas sjell një vlerësim jo objektiv dhe jo të plotë.

Njëkohësisht, nga këqyrja e formularit të vlerësimit të punës, konstatohet se nuk është respektuar afati ligjor i realizimit të këtij vlerësimi, fakt që vjen në kundërshtim me pikën 1, të Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, sipas të cilit periudha e provës zgjat një vit nga data e aktit të emërimit.

Në rastin konkret rezulton se, marrëdhënia financiare për nëpunësen ***** ka filluar në datën 17.01.2017, ndërsa vlerësimi i rezultateve në punë është përfunduar në datën 10.04.2018, pra më shumë se 1 (një) vit, ndërkohë që nuk konstatohet ndonjë akt për shtyrje të afatit të periudhës së provës.

Në vijim të analizës së dokumentacionit të administruar, rezulton se kjo punonjëse, e vënë para faktit të vlerësimit negativ, ka mbetur e paqartë dhe është shprehur menjëherë se nuk është dakord lidhur me vlerësimin, duke kërkuar rishqyrtimin e tij nga zyrtari

autorizues (*fakt i cili gjen pasqyrim në ndarjen D, "Nënshkrimi", drejtuar zyrtarit autorizues*).

Nga këqyrja e formularit të vlerësimit, konstatohet se zyrtari autorizues si nëpunësi më i lartë civil i institucionit, nuk ka vepruar ashtu si parashikohet në pikën 14, të Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, duke mos marrë parasysh kërkesën për rivlerësim, si dhe duke mos arsyetuar vendimin për rrëzimin e kësaj kërkesë.

Nga sa parashtroam më sipër dhe nga analiza në tërësi e dokumentacionit, arrijmë në konkluzionin se vlerësimi përfundimtar, në fund të periudhës së provës për punonjësen *****, nuk është kryer në respektim të procedurës dhe përcaktimeve të sistemit të vlerësimit të rezultateve në punë e parashikuar në vendimin nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, "*Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil*", i ndryshuar, si dhe vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, "*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*".

Në këto rrethana, arrihet në përfundimin se formulari standard i vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, në rastin e nëpunëses *****, në kuptim të nenit 109, pika "d", të ligjit nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", përbën një akt administrativ të paligjshëm, e për këtë arsye, në referencë të nenit 114, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative për Republikën e Shqipërisë, ky formular duhet të anulohet.

Në vijim të këtij arsyetimi, edhe akti administrativ nr. 140, datë 18.04.2018, nxjerrë nga Kryeinspektori i ISHMPU, "*Për lirimin nga detyra*", të punonjëses *****, bazuar në një akt të paligjshëm, përbën një akt të paligjshëm dhe si rrjedhojë, vendimi për lirimin nga shërbimi civil, duhet të anulohet.

Me anulimin e këtyre akteve, në vijim të këtij procesi, subjektet që realizojnë vlerësimin e rezultateve në punë për periudhën e provës në këtë rast, duhet të marrin masa për përsëritjen e kësaj procedure, sipas orientimeve të dhëna më sipër dhe në përputhje me kërkesat ligjore të përcaktuara në ligjin nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", të ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij, duke njoftuar për këtë veprim edhe Departamentin e Administratës Publike, si njësi përgjegjëse.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, në ligjin nr. 44/2015, "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe në nenet 16 dhe 35, të

Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Të kërkoj nga Kryeinspektori i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, të anulojë urdhrin nr. 140, datë 18.04.2018, “Për lirimin nga detyra”, të nëpunëses *****, si një akt i dalë në kundërshtim me përcaktimet e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në zbatim të tij dhe me tej, këtë akt duhet t’ia njoftojë Departamentit të Administratës Publike, si njësi përgjegjëse.
2. Njësia e burimeve njerëzore në institucionin e ISHMPU, të drejtojë procesin për anulimin e formularit standard të vlerësimit të rezultateve në punë për periudhën e provës, për nëpunësen *****, si një akt i dalë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
3. Nëpunësit e ngarkuar me procesin e vlerësimit të rezultateve në punë pas periudhës së provës, në rolin e eprorit direkt, Zyrtarit Raportues/Kundërfirmues/Autorizues, duhet të përsërisin edhe një herë procesin e vlerësimit të kësaj nëpunëseje, në mënyrë objektive dhe të plotë, në respektim të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të Vendimit nr. 109, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësit civil”, i ndryshuar, si dhe Kreut VI, të vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, duke garantuar parimet e shërbimit civil gjatë procesit të vlerësimit; duke respektuar të gjitha fazat përkatëse të vlerësimit dhe duke e shoqëruar me dokumentacionin përkatës që materializon zhvillimin e këtyre fazave me qëllim që të sigurohet një vlerësim objektiv, i bazuar mbi ecurinë reale të punonjësës gjatë procesit të punës.
4. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 30 ditë, nga marrja dijeni për këtë vendim.
5. Me kalimin e këtij afati, njësia përgjegjëse është e detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
6. Në rast të mos respektimit të këtij vendimi, përgjegjësia do të jetë personale e subjekteve, që nuk kanë kryer detyrat e lëna në këtë vendim dhe në zbatim të përcaktimeve të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të

ndryshuar, Komisioneri do të vijojë procesin për rregullimin e shkeljeve të konstatuara, duke përdorur mjetet ligjore për të rikthyer ligjshmërinë në administrimin e shërbimit civil, nëpërmjet gjobitjes së nëpunësit përgjegjës për moszbatimin e masave të përcaktuara në dispozitivin e vendimit.

7. Të njoftohet për këtë vendim, Inspektorati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve dhe Ujërave, Departamenti i Administratës Publike dhe nëpunësja *****.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha